

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “RIPARIME MAKINASH”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):
50100000-6**

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Pastrimit Kamëz** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023- 2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit

të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- a) 1 (një) Drejtues Teknik/ Inxhinier Mekanik;
- b) 1 (një) motorrist;
- c) 1 (një) elektroaut;

Për punonjësit e mësipër ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK, me qëllim sigurimin e AK se shërbimi i riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi do të realizohet nga punonjës të kualifikuar për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Kërkesa për Drejtuesin Teknik/Inxhinier Mekanik është bazuar në pikën 2, neni 6 dhe nenin 9 në Ligjin Nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, i cili ka një rol të rëndësishëm në kryerjen dhe realizimin e shërbimit, objekt prokurimi në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara.

Referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, te sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit, etj është e nevojshme disponimi i një stafi teknik me profesione si motorist, elektroauto, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që kane nevojë për kryerjen e shërbimeve, si dhe natyrën dhe numrin e shërbimeve që kërkohen. Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës të cilat duhet të përmbushë gjatë kryerjes së këtij shërbimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve. Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin: dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe ambientet e duhura për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti se shërbimi, objekt prokurimi është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, të cilat duhet të dërgohen në ambientet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambient ku ushtron aktivitetin e tij.

Disponimi minimalisht i 1 (një) ambjenti ku ushtron aktivitetin e tij, lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri dhe garanci për AK që ofertuesi ka kapacitetet e domosdoshme për të përmbushur me sukses kontratën, në kohë dhe konform specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

a) Operatori ekonomik duhet të disponojë liçensa profesionale për ekzekutimin e shërbimeve dhe duhet të përmbajë specifikimet e mëposhtme:

- Servisi duhet të ketë jo më pak se 1 urë ngritëse për automjetet;
- Pajisje diagnostifikim difekti për automjetet e mësipërme;
- Aparat për regjistrim frenash;
- Aparat për mbushjen me gaz të kondicionuar;
- Linjë testimi elektronike për sistemin e frenimit të mjeteve;
- Pjesët e këmbimit të jenë origjinale dhe shërbimet të jenë me garanci jo më pak se 12 muaj nga data e ndërrimit/ shërbimit;

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, objekt prokurimi.

Duke vlerësuar proceset e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes, disponimi i këtyre paisjeve, lidhet ngushtësisht me realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, duke krijuar garancinë e AK se oferteusit disponojnë pajisjet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës/ave, që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër. Specifikat e çdo pajisje janë të lidhur ngushtë me specifikat e përshkruara në zërat e riparimit të kërkuara.

2.3.5 Për sigurimin e cilësisë së produkteve që prokurohet dhe mbarëvajtjen e punës kërkohet që operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certifikatat e mëposhtme:

- ISO 9001:2015 Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë
- ISO 14001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit
- ISO 45001:2018 Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose Ekuivalente;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm pasi ndikon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve, duke qenë se ky standart

fokusohehet në cilësinë e procesit të riparimit të automjeteve, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi do të përmbushë/realizojë shërbimet objekt prokurimi, sipas pritshmërive/specifikimeve teknike të kërkuara. Implementimi i këtij standarti ndihmon në optimizimin e burimeve dhe përmirësimin e efikasitetit të shërbimeve, duke ulur kostot dhe kohën e riparimit.

Standarti 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” – është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që ky Standarti është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë shërbimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, procese gjatë të cilave përdoren produkte që mund të jenë të dëmshme për mjedisin, si vajrat dhe kimikatet. Paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që ofertuesi do të zbatojë politika të qëndrueshme mjedisore, duke zvogëluar ndotjen dhe ndikimin e dëmshëm në mjedis.

Standarti ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” është vendosur si kriter me qëllim që AK të sigurohet që ofertuesi kryen shërbimin në përputhje me standartet e kërkuara sa i takon shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe me qëllim parandalimin/shmangien e çfarëdo rreziku, pasi shërbimet që do të kryhen përfshijnë një sërë rreziqesh për aksidente në punë, si dëmtime nga makineritë që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve, djegie nga substanca të nxehta, lëndime nga kontaktet me kimikate toksike apo ndotëse, madje edhe ndotje akustike.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencën e kategorisë VII.3.B.1, “Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe te motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, e cila duhet të jetë Brenda afateve të vlefshmërisë, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9573, datë 03.07.2006. për pikat a, b, c, ç, për ambientin ku ushtron këtë aktivitet.
- Operatori ekonomik duhet të ketë Leje Mjedisit të tipit III.1.B “Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 ”Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Ky kriter vendoset mbështetur në Ligjin Nr.9573, datë 3.7.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to”, neni 4, si dhe Udhëzimin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, me nr.1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, duke siguruar AK që shërbimet objekt prokurimi do të realizohen nga subjekte që respektojnë legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor dhe për normat e kujdesit ndaj mjedisit, ndaj ndotjeve dhe parandalimit të dëmtimeve dhe që janë të regjistruara sipas këtij ligji.

Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë deklaratën me shkrim se mban garanci për pjesët e këmbimit/shërbimit të ofruar se kanë garanci 1 vit nga kryerja e shërbimit.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili garanton AK për realizimin e shërbimit sa **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor me urdhërin nr 710 prot., datë 06.07.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit”

NJËSIA E PROKURIMIT:

ARNELA SHAHU

ARILDA MATA

LEONORA NESIMI

